



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 275/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur lidhur me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, e paraqitur ndaj subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 06.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.275/2019 e datës 05.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të vazhimit të sponzorimit të fushatës zgjedhore në Radio Televizionin e Kosovës (RTK), në ditën e heshtjes zgjedhore.

A r s y e t i m

Me datë 05.10.2019 Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA ka paraqitur në PZAP, ankesën Anr.275/2019, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën ka pretenduar, se me datë 05.10.2019 pas mesnatës, Radio Televizioni i Kosovës (RTK), ka transmetuar një spot publicitar propagandues politik, të subjektit LDK, në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast shihet qartë se ky veprim është në kundërshtim me LZP-në, rregullat zgjedhore dhe Kodin e Mirësjelljes së partive politike që ndalojnë bërjen e çfarëdo fushate zgjedhore në ditën e heshtjes zgjedhore. Paraqitësi i ankesës si provë për pretendimet e tij ka bashkangjitur ankesës një fotografi lidhur me rastin në fjalë.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe provës materiale – fotografisë së bashkangjitur, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli nuk mundi të konstatoj datën e spotit të supozuar, i transmetuar në Radio Televizionin e Kosovës (RTK).

Nga provat e ofruara nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se data e spotit të transmetuar përputhet me datën e heshtjes zgjedhore, sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar data dhe ora e spotit të supozuar siç pretendohet në ankesë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.275/2019 më datën 06.10.2019

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademij



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.*